
RECENSIONE

NATHALIE CLAYER: “NË FILLIMET E NACIONALIZMIT SHQIPTAR: LINDJA E NJË KOMBI ME SHUMICË MYSLIMANE NË EVROPË”, Shtëpia Botuese “Përpjekja”, Tiranë 2009, f. 683

Libri i fundit i studiueses Nathalie Clayer me titull; “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë”, është një vepër padyshim me disa të dhëna të reja dhe me analiza interesante. Kështu, Nathalie Clayer, në shtesën e librit “Epilog”, jep për mendimin tim, përfundime të sakta kur thekson, se forcimi i identitetit kombëtar shqiptar, u bë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa, në Kosovë veçanërisht pas viteve 60 të shek. XX. Por, përsëri duhet shtuar se ky proces i zhvillimit dhe forcimit të identiteteve kombëtare, nuk ishte karakteristikë vetëm për shqiptarët, por edhe për kombet e tjera në ish-Jugosllavinë. Kështu më 1945 pranohet ekzistenca e kombit maqedonas, ndërsa pas viteve 60 të shekullit XX zyrtarizohet kombi boshnjak. Gjithashtu, ajo me të drejtë thekson, se konfliktit i serbëve dhe shqiptarëve gjatë viteve 1997-1999 ishte pa ngjyrimë fetare, bile edhe atëherë kur sulmoheshin objektet e kultit të njëri-tjetrit, pra mbi të gjitha ky ballafaqim kishte karakter kombëtar.

Pavarësisht vlerave të punimit, nuk mund të mos përmendim konstatimet e pasakta për historinë shqiptare. Veçanërisht, kjo dukuri vërehet me pjesën e parë të librit, në të cilën terminologjia e përdorur, analizat e njëanshme dhe përfundimet e autores, të pabazuara në burimet arkivore, do të çonin detyrimisht në konstatime të gabuara. Kundërshtimi im me shumë objektivitet e mirëdashje për autoren, nis që në titullin e librit “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar (Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë)”. Titulli i librit, reflekton qëndrimin se vetëm shqiptarët, në ndryshim nga të gjitha kombet e Ballkanit, nuk kanë pasur një periudhë të Rilindjes Kombëtare, por lëvizja e tyre që nga fillimi ishte nacionaliste, që mua më tingëllon urrejtëse, e nxitur dhe e drejtuar kundër fqinjëve të tyre sllavë dhe grekë. Rrjedhimisht autorja nuk ka pengesë që shqiptarët t’i përjashtojë nga të qenit komb dhe pse jo t’i quajë vetëm si “shqipfolës”, pra pa identitet të mirëfilltë kombëtar.

Në vazhdim, ajo përsëri bie në kundërshtim me përfundimet e veta. Studiuesja Clayer, shkruan për “nacionalizmin shqiptar” të “shqipfolësve”, ndërkohë që shprehet se kombi shqiptar u formua, vetëm pas krijimit të shtetit shqiptar, madje dhe këtë e daton në vitet 20 të shekullit XX. Nisur nga kjo, shtrohet pyetja: si ka mundësi që një popull të jetë nacionalist, ndërkohë që identiteti i tij kombëtar nuk është aq i zhvilluar ose i shprehur? E bëj këtë

pyetje pasi, koncepti i zhveshur “revolucionar” i zonjës Clayer, mbi kinse, mitin e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare, bie ndesh me historinë e zgjimit kombëtar evropian të shekullit XIX. Ai bie ndesh, gjithashtu, dhe me periudhën letrare të quajtur “romantizëm”, që, sipas formulimit të autores, do të duhej të quhej “nacionalizëm”. Mos ndoshta studiuesja Clayer ka mbivlerësuar procesin e demistifikimit të historisë shqiptare dhe nuk ka mundur të bëjë dallimin midis mitit dhe faktit historik?

Vazhdimi i titullit të librit “Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë”, mendoj se është jo vetëm i gabuar, por edhe qëllimkeq. Në pjesën më të madhe të veprave shkencore që merren seriozisht me historinë më të re evropiane, nuk ndeshen tituj që metojnë e favorizojnë të studiuarit e boshtit fetar, duke injoruar atë kombëtar. Për më tepër, mënyrën se si autorja e shtron dhe e shtjellon çështjen, shtrembërohet jo vetëm historia religjioze e etnisë shqiptare, por kjo histori vihet në pozita artificialisht të barabarta me kombet, të cilët e identifikojnë veten, vetëm me përkatësinë fetare. Dihet mirëfilli fakti se barazimi i kombësisë dhe përkatësisë fetare është tipar identifikimi për serbët, grekët, boshnjakët dhe për kombe të tjera, pjesëtarët e të cilëve konsiderohen vetëm ata, që i takonin të njëjtit religjion. Ndërsa, shqiptarët, edhe pse praktikojnë tre besime të ndryshme fetare, si rrallë ndonjë komb tjetër në Evropë, qysh në gjysmën e dytë të shek. XIX, i kishin tejkaluar ndasitë fetare. Ata platformën e tyre kombëtare e patën krijuar duke lënë mënjane identitetin fetar dhe ndarjet krahinore. Do të doja t’i kujtoja autores, se në epokën kur u ngjiz kombi shqiptar janë ngjizur dhe ai gjerman (të besimit protestant dhe katolik), ukrainas (besimtar ortodoks dhe unitë) etj, të cilët gjithashtu nuk u mbështetën mbi identitetin fetar, por në atë etnik. Mirëpo, asnjëherë për këto kombe nuk thuhet “lindja e një kombi me shumicë protestante për gjermanët ose lindja e një kombi me shumicë ortodokse për ukrainasit”. Andaj, pyes: Pse të theksohet përkatësia fetare vetëm për rastin e shqiptarëve?

Areali shqiptar, gjithashtu ishte edhe vendi i parë i uniatizmit të krishterë, duke filluar që me Skënderbeun, pak më vonë me arbëreshët unitë në Kalabri e Sicili, për të vijuar edhe në fund të shekullit XIX me shpatarakët e krahinës së Elbasanit¹. Shqipëria është edhe qendra botërore e bektashinjve, filozofi fetare kjo, e konsideruar si religjioni i tyre i katërt. Pra, e kaluara e popullit shqiptar është historia e Evropës së krishterë, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të flitet për një komb me histori botëkuptimesh e ngjyrimesh islamike.

Për më tepër, edhe zyrtarët më të lartë ushtarakë e civilë të Perandorisë Osmane, asnjë herë nuk i kanë konsideruar tokat shqiptare si hapësira myslimane. Madje, ata ishin të gatshëm që Shqipërinë dhe Maqedoninë, t’i

¹ Shkëlzen Raça, *Gjurmime në Historinë Shqiptare*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2009, f. 134.

shkëmbenin me viset myslimane të Kaukazit dhe të Krimesë². Gjithashtu, raportet e diplomatëve të Perandorisë Ruse nga Konsullatat e Manastirit dhe Prizrenit, kur flitnin për shqiptarët, theksonin se, më shumë se besimi fetar, ata i lidhnin traditat e tyre³.

Prandaj është për t'u habitur me zonjën Clayer, e cila në kundërshtim me të gjitha burimet dhe shpjegimet racionale lidhur me vështirësitë me të cilat ballafaqohej Lëvizja Kombëtare Shqiptare, këmbëngul shumë në dallimet fetare dhe rajonale të shqiptarëve, edhe për çështje të alfabetit⁴. Si zakonisht, ajo rithekson reagimin e shqiptarëve të besimit mysliman kundër alfabetit latin, ndërkohë që ashtu kalimthi shprehet se kjo rezistencë vinte posaçërisht nga Vilajeti i Kosovës. Rezistenca të tilla kundër përparimit ishin shumë të pranishme edhe te popujt e krishterë evropianë, por nuk duhet anashkaluar se ky konflikt nuk kishte karakter fetar, duke qenë se te shqiptarët, ai edhe zhvillohej brenda komunitetit fetar mysliman. Në fund të fundit, ishte vetë Perandoria Osmane, ajo e cila pranoi se alfabeti më i përshtatshëm për shqiptarët ishte ai me shkronja latine⁵. Nuk duhet harruar gjithashtu se në historinë e njerëzimit, nxitësit e ndryshimeve dhe të revolucioneve, kanë qenë zakonisht grupe të vogla ëndërrimtarësh.

Autorja, me të drejtë thekson, se “nacionalizmi shqiptar u mbështet mbi gjuhën dhe kishte pengesa të shumta si ndarjen fetare, kundërshtimin e fqinjëve dhe të Perandorisë Osmane dhe mungesën e një ndihme nga jashtë”⁶. Pra, ajo i identifikon drejtë faktorët që kanë ndikuar në fillesat relativisht të vona, në krahasim me kombet e tjera të Ballkanit, të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Mjerisht në vazhdim të analizave, ajo nuk i përmbahet shkaqeve frenuese, të cilat vetë i thekson dhe për të qenë kontradikta më e madhe, fillet e zgjimit kombëtar shqiptar i identifikon me nacionalizëm. Konceptet e tilla, rastësi apo jo, përkrijnë me politikën dhe propagandën serbe, që çdo veprim në planin e emancipimit kulturor të kombit shqiptar e konsideronte si veprimtari nacionaliste, pra si fenomen i urrejtjes ndaj të tjerëve.

Njëanshmëria e saj vërehet edhe me emërtimin përcmues “shqipfolësit” për popullin shqiptar, dhe më tej vazhdon me emërtimet “Kosovë/Metohi”, “Sanxhaqet Maqedone”, “Epirotët” etj., të cilët nuk kanë ekzistuar në periudhën

² *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.PA.A.*), në *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 3-11-1166, Nr. 11. Fk. 1388-1391.

³ *AIH*, A-IV-112, f. 164.

⁴ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar-Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë: “Përpjekja”, 2009, f. 554.

⁵ Stavro Skendi, *The Albanian national awakening 1878-1912*, New Jersey: Princeton University Press, 1967, f. 389.

⁶ N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit ...*, f. 11.

në studim. Analizën do ta filloja nga termi “shqipfolësit”. Zonja Clayer, thotë se punimin e saj e ka mbështetur në burimet arkivore austro-hungareze, osmane, italiane dhe franceze, por jo në ato britanike. Kjo, në mendimin tim, është një mungesë serioze e studimit, pasi asnjë nga burimet britanike nuk i konsideron shqiptarët si “shqipfolës”, duke bërë dallimin e duhur mes identitetit kombëtar dhe shkallës së zhvillimit të këtij identiteti.

Autorja ka përmendur në punim veprimtarinë e Shoqërisë Biblike Britanike, duke mos u bazuar në burimet arkivore, por në raportet indirekte mbi veprimtarinë e kësaj shoqate. Ajo duhet ta kishte vënë re se në asnjë nga raportet e shumta të përfaqësuesve të kësaj Shoqërie, nuk flitet për “shqipfolës”, por për shqiptarë, të cilëve si shumë popujve të asaj kohe (serbëve, kroatëve, bullgarëve), u mungonte literatura fetare në gjuhën amtare⁷. Shqiptarët nuk përbënin përjashtim nga ky rregull, siç të krijohet përshtypja nga leximi i librit të zonjës N. Clayer. Një nga dëshmitë më të hershme që shkojnë kundër përfundimeve të autores, është letra e Dr. Pinkertonit drejtuar Shoqërisë Biblike në Londër më 28 gusht 1816. Ndër të tjera, ai vë në dukje: “Shumica e shqiptarëve janë të krishterë të deklaruar, që i takojnë rritit grek, ndërsa të tjerët janë aq shumë të zhytur në padituri sa që kanë pranuar muhamedizmin”⁸. Nuk bëhet fjalë, as kontestohet përkatësia etnike shqiptare, por vetëm në mënyrën më të drejtë identifikohen vështirësitë, shkaqet dhe arsyet e paditurisë së tyre. Kështu, ndarjet fetare dhe mungesa e shkrimeve në gjuhën shqipe, sipas letrës, janë fajtorët kryesorë të kësaj gjendje, nga e cila mund të dilej duke u afruar shqiptarëve, përkthimet biblike në gjuhën e tyre. Problemi që evidentohet ishte te arsimimi i shqiptarëve. Mirëpo, për një arsimim kombëtar në kushtet e shekullit XIX ishte i domosdoshëm ose autonomia kulturore, ose ekzistenca e një shteti kombëtar. Shqiptarët nuk i kishin as njërin dhe as tjetrin.

Për të argumentuar më tutje se përfundimet e studiueses Nathalia Clayer janë të gabuara, është e nevojshme të bëhen disa krahasime me lëvizjet e tjera kombëtare të hapësirës ballkanike. Kështu, edhe pse Serbia me Paqen e Bukureshtit të vitit 1812 ndërmjet Ruisë cariste dhe Perandorisë Osmane, kishte vendosur bazat e shtetësisë ajo ende nuk e kishte përjetuar Rilindjen e vet Kombëtare. Linguisti sloven Jernej Kopitar, e nxiti në atë kohë Vuk Karaxhiqin të merrej me mbledhjen e folklorit dhe materialeve për reformën e gjuhës serbe, si dhe të përkthente Biblën në gjuhën popullore serbe për Shoqërinë Biblike Britanike⁹. Kjo do të thotë se përkundër unitetit fetar ortodoks të serbëve, si dhe krijimit të një njësie autonome serbe në kuadër të

⁷ Stephen Batalden, Kathleen Cann, John Dean, *Sowing the World-The cultural impact of the British and Foreign Bible Society 1804-2004*, Sheffield: 2006, f. 258.

⁸ Cambridge University Library, Bible Society Agency, BSA/E3/8/1, Volume 5, f. 1.

⁹ S. Batalden, K. Cann, J. Dean, *Sowing the World...*, f. 254.

Perandorisë Osmane, ata si edhe shumica e ballkanasve nuk kishin një gjuhë të unifikuar e as Biblën të kuptueshme për masat popullore serbe. Pra, edhe pse ishin në pozita më të volitshme se shqiptarët ata qenë përsëri larg procesit të konstituimit kombëtar. Megjithatë, asnjë historiani nuk do t'i shkonte mendja t'i quante serbët “serbfolës” dhe nacionalistë, siç i quan shqiptarët studiuesja Nathalie Clayer.

Por të vijojmë më tej. Në vazhdim të punimit të saj, ajo rrëfen: “Shfrytëzimi i krahut të lirë të punës, që ndodhi në Greqi pas shembjes së regjimit komunist (Shqipëri), nuk është një fenomen krejtësisht i ri”¹⁰. Këto janë jo vetëm përfundime joserioze por edhe shumë ofenduese, duke e paraqitur popullin shqiptar, të paafte për çdo lloj tjetër të punës, pos asaj fizike. Ajo harron, se shekulli XIX-XX ishte shekull i migrameve masive të evropianëve, në vendet më të zhvilluara të perëndimit si, në SHBA-të, në Kanada e Australi, më vonë edhe në RF të Gjermanisë. Cilat ishin punët që i kryenin emigrantët evropianë fillimisht në këto shtete? Natyrisht, kryenin të njëjtat punë të pakualifikuara, me të cilat u punësuan edhe emigrantët shqiptarë në fillimet e emigrimit të tyre. Pse atëherë autorja e lartpërmendur, flet në mënyrën e tillë përbuzëse për shqiptarët, sikur ai fenomen ka të bëjë vetëm me pasardhësit e iliro-arbrit?

Autorja Clayer, për një kohë të gjatë është angazhuar në fushën e studimeve bektashiane. Ajo bën të ditur se autorët si: Ippen e Hahn e paraqitën këtë sekt fetar si një drejtim të liberalizmit islamik dhe tolerant në krahasim me sunizmin, për ta bërë atë më evropian dhe “joturk”¹¹. Autorja nuk e pranon këtë këndvështrim, madje ajo i kritikon të gjithë ata, të cilët përpiqen që islamin e shqiptarëve ta paraqesin ndryshe nga islami i turqve. Pra, sipas logjikës së saj edhe krishterimi qenka unik, pa veçori territoriale e kombëtare? Në mënyrën si e shtron autorja çështjen shqiptare, të krijohet përshtypja se ajo ishte “pjellë” e një konspiracioni austro-hungarez i drejtuar kundër interesave sllave dhe greke. Zonja Clayer merr rolin e avokatit, duke pretenduar se konsulli August Kral, financonte veprat e At Gjergj Fishtës, vetëm se ato nxisnin ndjenjat antisllave¹². Rrjedhimisht, sipas mënyrës së saj të menduarit, shqiptarët duhet të fshijnë nga kujtesa historike luftërat me pushtuesit malazet, serb e grek, fenomen që do të ishte i njëjtë, sikur të kërkohej nga francezët, të mos botonin vepra mbi Zhan D’Ark, sepse ato nxisin ndjenjat antiangleze. Për të qenë absurdi edhe më i madh, ajo arrin deri aty sa ta mohojë ekzistencën etnike të shqiptarëve duke përfunduar se: “. . . ekuilibrat etniko-fetare dhe sociopolitike ndryshonin shumë

¹⁰ N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit . . .*, f. 121.

¹¹ *Po aty*, f. 440.

¹² *Po aty*, f. 536.

dhe kjo në një masë të tillë saqë nuk mund të flitet në mënyrë të përgjithshme për “shqiptarë”¹³.

Ndërkaq, burimet austro-hungareze, në të cilat autorja, pretendon se është mbështetur punimi i saj, pohojnë të kundërtën. Kështu, në letrën që nënkonsulli austro-hungarez i dërgon Gaetano Kavaliere Zagorskit, konsullit perandorak në Janinë, pos të tjerash thuhet se, kriza në të cilën po kalonte Perandoria Osmane, godiste rëndë kombësitë e ndryshme, e sidomos kombin shqiptar, i cili duhej të përballej edhe me pretendimet territoriale të malazezëve, serbëve dhe grekëve.¹⁴ Në vazhdim të letrës, ai kritikon përkrahjen që disa shteteve evropiane, i kishin dhënë pretendimeve territoriale të fqinjëve të shqiptarëve, duke i përligjur kërkesat e tyre herë me kritere historike, etnike e herë me ato fetare. Pra, as që bëhej fjalë për mohimin e kombit shqiptar, por shpjegohen drejtë se keqkuptimet rrjedhin nga mosnjohja e gjendjes faktike, që kanë sjellë si pasojë vendimet e gabuara të Fuqive të Mëdha.

Autorja e veprës së lartpërmendur, në analizat e saj shkon aq larg sa mohon edhe veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke hedhur xhevahirin se: “Mund të ishte **veprimtar i shqiptarizmit** për të shprehur kundërshtimin ndaj regjimit hamidian, por mund të ishte i tillë edhe për interes, ose edhe duke e marrë si lojë.”¹⁵ Nga ky përfundim i saj përçmues, rrjedhë një kontradiktë e çuditshme. Së pari, për të qenë kundërshtar i regjimit Hamidian, do të mjaftonte të ishte me xhonturqit, pa pasur nevojë të identifikohesh me një “popull” që sipas Nathalia Clayer, nuk ekzistonte. Së dyti, si veprimtar i shqiptarizmit nuk pasurohesh, por përkundrazi varfërohesh, dhe për më tepër edhe burgoseshe. Ku ishte pra interesi të identifikohesh me një popull që rrjedhimisht nuk ekzistonte? Së treti, zonja Clayer, çështjen e interesit e ka kthyer përmbys, sepse në atë periudhë ishin ata që mohonin kombin shqiptar, që paguheshin mjaft mirë.

Fryma e saj filosllave dhe joshkencore, vërehet edhe në përdorimin e emërtimeve gjeografike dhe (mos)shfrytëzimin selektiv të literaturës dhe burimeve. Ajo, në asnjë rast nuk i referohet Historisë së Popullit Shqiptar, qoftë edhe për të adresuar ndonjë kritikë. Pra, sikur puna e të gjithë atyre historianëve, nuk ishte asgjë tjetër, përveç se mashtrim dhe manipulim. Ndërsa, çdo studiues i paanshëm, në shenjë të objektivitetit dhe të normave minimale të etikës shkencore, do t’i ishte referuar Historisë së Popullit Shqiptar.

Të gjitha sa më sipër, i japin kësaj vepre më tepër karakterin e një pamfleti politik antishqiptar, se sa shkencor. Nuk ke çfarë të thuash ndryshe, kur lexon në përfundim të punimit se “shqipfolësit” filluan të bëhen komb, falë interesave

¹³ *Po aty*, f. 133.

¹⁴ *HHS.A.P.A.A. në AIH*, Vj-36-16.

¹⁵ N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit ...*, f. 485.

të Fuqive të Mëdha, e veçanërisht të Perandorisë Dualiste. Ndërkohë që, harrohet, se ishte Austro-Hungaria, e cila kishte hapur shkolla dhe institucione të tjera arsimore për shtetasit e saj serbë, në një kohë kur pjesëtarët e së njëjtës etni në Perandorinë Osmane nuk kishin as edhe një shkollë publike. Rrjedhimisht, nëse Perandoria Habsburgase kishte merita për “ringritjen artificiale” të kombit shqiptar, mund të themi se meritat e saj për rilindjen, prosperitetin, lirinë dhe zgjerimin territorial të kombit serb ishin më të dallueshme. Mesa duket, nuk është qëllimi i autores, krijimi i një pasqyre reale për të kaluarën e shqiptarëve, por i një historie të shtrembëruar të një kombi që po kalonte momente të vështira ekzistenciale, ndaj të cilit, fqinjët silleshin si ndaj një “hapësire të zbrazët”, të cilën ata mund ta pushtonin dhe ta ndanin mes tyre, dhe që mjerisht ajo vë në thumb të kritikës të gjithë ata, që u munduan t’i ndihmojnë dhe të parandalojnë asimilimin dhe copëtimin e trojeve të tija. Si duket se, Nathalia Clayer, është përkrahëse e atyre botëkuptimeve të tejkaluara, të cilat duke mohuar autoktoninë e shqiptarëve, historinë dhe duke theksuar besimin islam të një pjese të tyre, argumentonin pretendimet territoriale ndaj hapësirës etnike shqiptare.

Memli KRASNIQI

